



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Personat e Pagjetur dhe Peticione
Nr. 08-
Prishtinë, më 6.5. 2008, në orën 13,30
Ndërtesa e Kuvendit, salla C- 301

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me shqyrtimin e petitionit të nënshkruar nga 25 veta të SP "Kompresor" nga Gjakova

Morën pjesë: Ismet Beqiri - kryetar, Hajredin Hyseni, Radmila Vujović, Sanije Alijaj, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Vezira Emrush dhe Shpresa Murati - anëtarë.

Ishin të ftuar:

Dr. Veton Vula - nga Avokati i Popullit,
Teki Shehu -nga AKM-ja,
Ismet Leka -nga SP "Komprosor" nga Gjakova,
Xhevdet Podrimja- nga Gjakova,
Hasan Pozhari- nga Gjakova,
Mentor Luzha -nga Gjakova dhe
Qazim Tafaj- nga Gjakova .

Dëgjimin e monitoruan:

Lejla Selimi -nga OSBE-ja

Mediet nuk iu përgjigjën ftesës edhe pse ishin të informuara me kohë.

Kryetari ia propozoi Komisionit këtë

REND DITE

1. Vendimi i Komisionit për mbajtjen e dëgjimit publik lidhur me shqyrtimin e peticionit të nënshkruar nga 25 punëtorët që janë larguar nga marrëdhënia e punës prej ndërmarrjes “Kompresor” të Gjakovës
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
3. Të ndryshme

Komisioni vendosi që pika e dytë dhe e treta e rendit të ditës të mos shqyrtohen.

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

U hap diskutimi për pikën e parë.

1 Vendimi i Komisionit për mbajtjen e dëgjimit publik lidhur me shqyrtimin e peticionit të nënshkruar nga 25 punëtorët që janë larguar nga marrëdhënia e punës prej ndërmarrjes “Kompresor” të Gjakovës

Ismet Beqiri – U dëshiroi mirëseardhje të ftuarve dhe vuri në pah: Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione ka rëndësi të veçantë nga se në fushëveprimtarinë e tij ushtrohen katër funksione: të drejtat e njeriut, barazia gjinore, personat e pagjetur dhe peticionet. Pra, kërkesa juaj, që është objekt shqyrtimi, gërshetohet edhe me të drejtat e njeriut. Komisioni ka karakter të monitoruesit të zbatimit të ligjeve dhe të shtytësit të ligjshmërisë duke u ofruar rekomandime organeve të cilave u adresohen për zgjidhjen e tyre.

Ai i njoftoi të pranishmit për rregullat e dëgjimit publik dhe nënvizoi: Komisionit i drejtohen me peticione qytetarët kur konsiderojnë se organet ua kanë shkelur të drejtat e tyre. Pra, qëllimi është grumbullimi i informacioneve të nevojshme për të marrë vendime përkatëse. Komisioni nuk i zgjidh çështjet, por i adreson në institucionet përkatëse duke e ofruar zgjidhjen e tyre. Ai e çmoi lart besimin e qytetarëve që e kanë tek institucionet e Republikës së Kosovës. Prandaj synohet një informim më i thelluar lidhur me këto peticione, në mënyrë që qytetarët të jenë të kënaqur me përgjigjen. Deri tani studimet kanë treguar dëshimimi para Komisionit Parlamentar është treguar metodë e rëndësishme dhe efikase. Ai hapi debat për këtë pikë.

Ismet Leka – Sindikata e Pavarur e “Kompresorit” nga Gjakova e falënderoi Komisionin për organizimin e këtij dëgjimi duke e admiruar besimin e tij. Ai ceku se veprimet e organeve qeveritare dhe të atyre joqeveritare, që kanë zbatuar ligje diskriminuese me rastin e marrjes së vendimeve ndaj punëtorëve, në fakt janë në kundërshtim me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e miratuar nga OKB-ja më 1948 dhe kërkojnë jetësimin e nenit 23 pikat 1,2,3 dhe 4 dhe zbatimin e saj. Ai shprehu pakënaqësi ndaj AKM-së për mënyrën e privatizimit të ndërmarrjes së tyre dhe mbetjes jashtë marrëdhënies së punës të një numri të punëtorëve, që nuk gëzojnë kurrfarë të drejte. Pastaj kërkoi të gjendet zgjidhje për personat mbi moshën 35-vjeçare, që kanë mbetur të pambrojtur në mënyrë institucionale. Foli edhe për çështje të tjera që lidhen me statusin e punëtorit. Kërkesës ia bashkëngjiti 25 nënshkrime dhe kërkoi që sa më shpejt të zgjidhet

çështja e tyre, kurse nga AKM-ja kërkoi t'i kryejë obligimet e marra dhe ta zbatojë Ligjin nr. 2001/27 për punëtorët në të cilin parashihet t'u jepen nga pesë rroga si dhe ato që kanë mbetur pa i marrë.

Teki Shehu – nga AKM-ja, duke u ndërlidhur me parafolësin, shtoi: Procesi i privatizimit ka filluar në vitet 2001-2002. Ka të drejtë kur thotë se punëtorët janë në gjendje të vështirë sociale. Pra, qasja e privatizimit e AKM-së është bërë në dy metoda: në bazë të spin-offit-it special, sipas së cilës kreditori merr obligime - ndaj ndërmarrjes dhe punëtorëve - që parashihen në kontratë. Ai shtoi se ndërmarrja “Kompresor” nga Gjakova nuk është privatizuar në këtë mënyrë, por në mënyrën klasike, sipas së cilës kreditori nuk ka obligime ndaj punëtorëve, që më parë ishin të punësuar në të, duke mos i respektuar kriteret e metodës së parë. Në këtë rast fjala është vetëm për çmimin. Prandaj politika lidhur me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, e zbatuar nga ana e AKM-së, më tepër ka pasur për qëllim t'i mbronte kreditorët sesa punëtorët. Në fund, në vija të trasha, diskutoi për ndryshimet që do t'i kemi në përbërjen e trupit të AKM-së. Sipas Pakos së Ahtisarit do të jenë tre anëtarë të jashtëm. Çështja e punësimit nuk bie në fushëveprimin e AKM-së. Gjithashtu çështja e rrogave nuk ka ecur me temp të duhur. Theksoi se shkaqet e likuidimit të ndërmarrjeve janë më tepër të natyrës ligjore.

Veton Vula – nga Avokati i Popullit, shtoi se rastin e prezantuar ia kemi adresuar MPMS-së që punëtorët t'i realizojnë të drejtat e tyre dhe i kemi udhëzuar t'i shfrytëzojnë të gjitha mjetet juridike.

Xhevdet Podrimja – Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi: Kemi punuar me dekada në ndërmarrjen “Kompresor”, por tani kemi ngelur në terr.

Hasan Pozhani – Shprehu pakënaqësinë se pas 41 vjetësh jetë, në varfëri të skajshme, nuk mund ta realizojë ndihmën sociale.

Sanije Alijaj – I përshëndeti mysafirët dhe i njoftoi se në legjislaturën e parë ka ekzistuar Komisioni për Peticione që i ka shqyrtuar peticionet që kishin të bënin me privatizimin e ndërmarrjeve, pra me transformimin e ndërmarrjeve dhe të aseteve të tyre. Ceku se në atë kohë AKM-ja kishte rolin e një qeverie që përcaktonte rregulla të veçanta, siç është 20% etj. Prandaj, shihet se kërkesa juaj është punësimi mbi moshën 35-vjeçare. Ju sugjeroj se Komisioni do ta adresojë kërkesën e tyre në vendin e duhur. Ne ju dëgjojmë dhe kërkojmë të na ofroni prova, që në njërin nga mbledhjet t'i nxjerrim konkluzionet që do t'i dërgohen Qeverisë së Kosovës. Duke u përgjigjur për çështjen e papunësisë tha se ky fenomen është i pranishëm në tërë Kosovën.

Hajredin Hyseni – Shtroi pyetje pse nuk u janë dhënë punëtorëve 2 – 5 pagat e parapara.

Ibrahim Makolli - Nga diskutimet tuaja shihet se kanë ngelur pa dhënë 2-5 paga. Gjithashtu, në këtë kontekst, u cek edhe kërkesa për pensionimin e punëtorëve mbi moshën 35-vjeçare. E mbështet diskutimin e Sanije Alijajt lidhur me ligjet, sepse Kosova ka ligje që i përcaktojnë kriteret dhe moshën. Ai kërkoi sqarim nga ata se cilat janë kërkesa e tjera të tyre.

Vezira Emrush - Duke u ndërlidhur me parafolësit, në vija të trasha, foli për gjendjen e rëndë të punëtoreve të papunë. Ajo kërkoi të dhëna për mjetet e çdo ndërmarrjeje që i kanë të regjistruara, duke kërkuar informim për vlerën e mjeteve që i kanë pasur në dispozicion, si dhe kontributin që e kanë dhënë punëtorët. Në fund tha se për punëtorët e mbetur në rrugë dikush duhet të përgjigjet.

Luljeta Shehu - Kërkoi shpjegim nga përfaqësuesi i AKM-së se në ç'kritere janë bazuar se cilët punëtorë do të pranohen në punë e cilët jo?

Pyetjeve të deputetëve iu përgjigjën përfaqësuesit e AKM-së dhe të Avokatit Popullit që u mirëpritën nga të pranishmit.

Ishte konstatim i përgjithshëm se kjo formë e organizimit të shqyrtimit të peticioneve do të japë rezultate pozitive. Po ashtu Komisioni mori lëvdata nga ushtruesit e peticionit.

Përfundoi në orën 15:20

Procesverbalin e hartoi
Rrahim Demaj - zyrtar i lartë ligjor

Kryetari i Komisionit
Ismet Beqiri

